



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT DHE UJIT

V E N D I M

Nr. 21 datë 25.09.2025

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “N’ DRIT, KOMPLEKS
BANIMI DHE SHËRBI MI ME 1- 8 KATE MBI TOKË DHE 1 - 4 KATE NËNTOKË”
ME VENDNDODHJE NË SELITË, KODRA E DIELLIT, BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Star Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “N’ Drit, Kompleks banimi dhe shërbimi me 1- 8 kate mbi tokë dhe 1 - 4 kate nëntokë” me vendndodhje në Selitë, Kodra e Diellit, Bashkia Tiranë, me zhvillues “Star Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet kërkuesit vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë;
4. Vendimi Nr. 24, datë 25.06.2025 i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Godinë banimi dhe shërbimi me 1, 2, 3 dhe 5 kate mbi tokë dhe 3 kate parkim nëntokë”, me vendndodhje në Selitë, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Star Construction” sh.p.k., shfuqizohet.
5. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit dhe Ujit, hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKTU-SË

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 29/01/2026